



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PUKË
SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 185 Prot.

Datë 26 / 01 / 2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. 2 Datë 26.01.2024

PËR

**“ MIRATIMIN E KRITEREVE SPECIFIKE PËR FONDIN 6% TË NDIHMËS
EKONOMIKE PËR VITIN 2024”**

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015 “Për vetqeverisjen Vendore”, Ligji Nr.57/2019, date. 18.07.2019 “Për Asistencen Sociale në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në VKM nr.597 date 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përfitimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” si dhe bazuar në Udhëzimin Nr.5 datë 17.02.2017, “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%”

VENDOSI

Miratimin e Kriteriave Specifike për vitin 2024 mbi të cilat do të bazohet Vendimi i Këshillit Bashkiak për të trajtuar me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike, familjet të cilat nuk shpallen fitues sipas formulës së pikëzimit.

- 1-Familje të varfëra pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme, që nuk plotësojnë nevojat bazë për jetesë.
- 2-Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtare më aftësi të kufizuar/invalid pune.
- 3-Familje me shumë fëmijë.
- 4-Familje me k/familjare femra pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme.
- 5-Familje me k/familjare femra me të ardhura të pamjaftueshme, dhe probleme sociale.
- 6-Persona që jetojnë të vetëm ,të moshuar apo dhe të rinj me probleme social ekonomike.

- 7-Familje me të ardhura të pamjaftueshme që kanë në përbërje fëmijë që ndjekin arsimin e lartë.
- 8-Familjet që nuk kanë banesë ose jetojnë me qera.
- 9-Familje që kanë në përbërje të moshuar,që nuk kanë pension ose e kanë pension minimal.
- 10-Kryefamiljare të veja apo të divorcuara pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme.

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Ndihmës Ekonomike.

HARTUESI

Lavdie Ferbuni

JURISTI

Aida Sinani

KRYETARI

Rrok Dodaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE
DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 185/1 Prot

Pukë më 26 /01/2024

RELACION

PËR

“MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE, DUKE PËRDORUR 6% TË FONDIT TOTAL TË NDIHMËS EKONOMIKE PËR VITIN 2024”

Në zbatim të ligjit nr. **139/2015** “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji nr **57/2019**, date **18.07.2019** “Per Asistences Sociale ne Republiken e Shqiperise”, VKM Nr. **597**, datë **04.09.2019**, “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”; Mbi zbatimin e vendimit Nr. **5**, date **17.02.2017**, “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri 6%”.

Ne bazë të nevojave që ka Bashkia Pukë dhe në përputhje me ligjin Sektori I Ndihtes Ekonomike dhe Sherbimit Social ka paraqitur paar Keshillit Bashkiak kriteret specifike të fondit 6% për vitin 2024 për familjet që shpallen jo fituese sipas formulës së pikëzimit.

Sektori i Ndihtes Ekonomike

Lavdie Terbuni